

VENDIM
Nr. 426, datë 26.6.2019

**PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT, TË FUNKSIONIMIT, SI DHE KRITERET
E PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË KOMITETEVE SEKTORIALE DHE
MËNYRËN E SHPËRBLIMIT TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 11, të ligjit nr. 10247, datë 4.3.2010, “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komitetet sektoriale, të krijuara me ligjin nr. 10247, datë 4.3.2010, “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”, të ndryshuar, organizohen në formën e grupeve teknike për çdo sektor, jo më shumë se 10 komitete, me përbërje jo më shumë se 10 (dhjetë) anëtarë, përfaqësues të sektorit publik e privat, si më poshtë vijon:

- a) Një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin;
- b) Një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional;
- c) Një përfaqësues nga ministria/të përgjegjëse për sektorin/ët përkatës të veprimtarive ekonomike;
- ç) Një përfaqësues nga shoqatat e punëdhënësve të sektorit përkatës, me numrin më të madh të anëtarëve në sektorin përkatës;
- d) Një përfaqësues nga shoqatat e punëmarrësve të sektorit përkatës, me numrin më të madh të anëtarëve në sektorin përkatës;
- dh) Një përfaqësues nga institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional (AFP) të sektorit përkatës, me numrin më të madh të nxënësve/kursantëve në sektorin përkatës;
- e) Një përfaqësues të biznesit me praktika të pasura në zhvillimin e burimeve njerëzore në sektorin përkatës;
- ë) Një deri në tre ekspertë të pavarur, me përvojë jo më pak se 5 (pesë) vjet në zhvillimin dhe zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

2. Kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të komitetit sektorial janë, si më poshtë vijon:

a) Anëtarët e komitetit sektorial, përfaqësues sipas shkronjave “a”, “b”, “c” dhe “dh”, të pikës 1, të këtij vendimi, duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- i. Të jenë njohës të mirë të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, në vijim KSHK;
- ii. Të kenë përvojë të provuar për zhvillimin dhe zbatimin e KSHK-së;
- iii. Të jenë njohës të mirë të sektorit përkatës.

b) Anëtarët e komitetit sektorial, përfaqësues sipas shkronjave “ç”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij vendimi, përveç kriterëve të parashikuara në shkronjën “a”, të pikës 2, të këtij vendimi, duhet të kenë eksperiencë të provuar, të paktën 3 (tre) vjet në sektorin përkatës.

3. Anëtarët e komiteteve sektoriale zgjidhen për një periudhë 4-vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje dhe në rast zëvendësimi, anëtari vazhdon mandatin e paraardhësit.

4. Përzgjedhja e anëtarëve të parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “dh”, të pikës 1, të këtij vendimi, bëhet nga ministria përgjegjëse respektive, bazuar në plotësimin e kriterëve të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi.

5. Përzgjedhja e anëtarëve të parashikuar në shkronjat “ç”, “d”, “e” dhe “ë”, të pikës 1, të këtij vendimi, për anëtar të Komitetit Sektorial, kryhet nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, në vijim AKAFPK. Kjo e fundit, në përzgjedhjen e kandidatit bazohet në plotësimin e kriterëve të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, si dhe meritës, sipas dokumentacionit të depozituar pranë saj nga kandidatët.

6. Në rast nevojë, në komitetin sektorial mund të përfshihen më shumë se një ekspert, të parashikuar në shkronjën “ë”, të pikës 1, të këtij vendimi, pa tejkaluar në çdo rast numrin prej 10 (dhjetë) anëtarësh të komitetit sektorial.

7. Në mbledhjet e komitetit sektorial mund të ftohen të marrin pjesë përfaqësues të njësive të vetëqeverisjes vendore, të institucioneve të arsimit të lartë etj. Pjesëmarrja në këto takime mund të bëhet në kuadrin e ftesës së bërë për këtë qëllim dhe/apo interesit të shprehur me shkrim nga ana e institucioneve të interesuara.

8. Komiteti funksionon në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale shtetërore dhe enteve publike” dhe në bazë të rregullores së miratuar me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional, e cila miratohet jo më vonë se 3 (tre) muaj nga ngritja e komitetit sektorial përkatës, me propozim nga ky i fundit.

9. Kryetari zgjidhet në mbledhjen e parë të komitetit dhe, si rregull, duhet të jetë anëtari me më shumë eksperiencë në çështjet që trajton ky komitet dhe në zhvillimin e zbatimit të KSHK-së.

10. Veprimtaria e komitetit sektorial ushtrohet pranë AKAFPK-së dhe mbështetet nga sekretariati teknik, i cili përbëhet nga punonjës të AKAFPK-së, të përcaktuar me urdhër të titullarit të institucionit.

11. Sekretariati Teknik i Komiteteve Sektoriale është përgjegjës për mbështetjen administrative dhe organizative të komiteteve sektoriale, për mundësimin e ekspertizës së nevojshme për çështje të caktuara, si dhe lehtësimin e komunikimit të komiteteve sektoriale ndërmjet tyre dhe me institucionet e tjera. Rregullorja e funksionimit të sekretariatit teknik miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional dhe të ministrit përgjegjës për arsimin.

12. Komiteti mbledhet rregullisht, të paktën 1 (një) herë në 3 (tre) muaj.

13. Ngritja dhe përbërja e komiteteve sektoriale miratohen me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe të ministrit përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional. AKAFPK-ja propozon sektorin/ët ekonomik/ë për të cilin/ët ngrihen komitetet sektoriale, në bazë të një analize të thelluar të zhvilluar për këtë qëllim dhe në bashkëpunim me partnerët socialë, duke angazhuar ekspertizën përkatëse për të zhvilluar analizat e kërkuara, nëse lind nevoja.

14. Shpërblimi për pjesëmarrje në mbledhje për çdo anëtar të komitetit sektorial bëhet sipas përcaktimeve të bëra në vendimin normativ të masës së shpërblimit të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore.

15. Funksionimi i komiteteve sektoriale dhe shpërblimi i anëtarëve të tyre përballohen nga buxheti i shtetit i miratuar për AKAFPK-në.

16. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe